

Bilanci i energjisë elektrike

Tremujori III - 2025

Tiranë, më 26 Nëntor 2025: Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, energjia elektrike në dispozicion u ul me 1,1 %.


Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike në këtë periudhë u ul me 31,3 %, duke arritur vlerën 1.075 GWh nga 1.565 GWh energji të prodhuar në tremujorin e tretë të vitit 2024.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 54,5 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 16,5 % dhe nga të tjerë prodhues në masën 29,0 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje), në tremujorin e tretë të vitit 2025, arriti vlerën 1.260 GWh, nga 762 GWh që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rritje prej 65,3 %.

Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti 312 GWh, nga 282 GWh, duke shënuar një rritje prej 10,8 %. (fig.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Për publikim 26/11/2025

Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike

		MWh	
Treguesit		Tr. III 2024	Tr. III 2025
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	2.045.345	2.023.262
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1.564.702	1.075.345
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	1.379.839	763.948
a	Publike	1.088.062	586.083
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	291.776	177.864
1.3	Të tjerë prodhues ¹	184.864	311.397
2	Importi bruto (energji në marrje)	762.297	1.259.905
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	281.655	311.988
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	2.045.345	2.023.262
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	343.788	323.399
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	44.956	45.272
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ²	298.832	278.128
a	Humbjet teknike në shpërndarje	233.923	223.361
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ³	64.909	54.766
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.701.558	1.699.863
2.1	Familjarë	839.265	840.267
2.2	Jo Familjarë	862.293	859.596

1 Të tjerë prodhues i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo, dhe duke përfshirë burime si (fotovoltaikë, naftë, etj.)

2 Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

3 Humbjet jo teknike përbëjnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në tremujorin e tretë të vitit 2025, prodhuan 586 GWh nga 1.088 GWh të prodhuar në tremujorin e tretë të vitit 2024, duke shënuar kështu një rënie të prodhimit me 46,1 %.

Hidrocentralet private dhe koncensionare, prodhuan 178 GWh nga 292 GWh të prodhuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 39,0 %.

Të tjerë prodhues, prodhuan 311 GWh nga 185 GWh të prodhuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 68,4 %.


Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në tremujorin e tretë të vitit 2025, ka arritur vlerën negative prej 948 GWh (fig.2).

Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike




Humbjet në rrjet kanë arritur vlerën 323 GWh në tremujorin e tretë të vitit 2025 nga 344 GWh në tremujorin e tretë të vitit 2024, duke shënuar një rënie me 5,9 %.

Pesha që zënë **humbjet në rrjet** në totalin e energjisë elektrike në dispozicion gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 është 16,0 % nga 16,8 % që ishte në tremujorin e tretë të vitit 2024 (fig.3).

Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e tretë të vitit 2025, u ul me 0,1 %, duke arritur vlerën 1.700 GWh nga 1.702 GWh që ishte në tremujorin e tretë të vitit 2024.

Në uljen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët kanë ndikuar kryesisht **konsumatorët jo familjarë**, të cilët shënuan një ulje të konsumit me 0,3 %, ndërsa **konsumatorët familjarë** regjistruan një rritje të lehtë prej 0,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024. (fig.4).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët

Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe linçensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.